



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 160 Prot.

Tiranë, më 01.03.2017

**V E N D I M**

**Nr. 44, datë 01/03/2017**

**"Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Lezhë"**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe nenit 34 të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë "*Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 89, datë 04.09.2015 "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Lezhë"*", në lidhje me procesin e inspektimit të administrimit të shërbimit civil, të zhvilluar në institucionin, Këshilli i Qarkut Lezhë,

**Vërej se:**

Në zbatim të Vendimit nr. 54, datë 08.06.2015, "*Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Lezhë*", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar inspektimi në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 89, datë 04.09.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil "*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Lezhë*", në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Këshillit të Qarkut Lezhë, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë, aktin e emërimit nr. 94, datë 01.10.2014, për nëpunësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Drejtor i Burimeve Njerëzore*” dhe nr. 26, datë 13.03.2015, për nëpunësin civil \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore*” dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
3. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë aktin e emërimit nr. 17, datë 02.03.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve*” dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
4. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë të revokojë aktin e emërimit nr.34, datë 21.03.2014 dhe aktin nr 18, datë 02.03.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist për Bujqësinë dhe Turizmin*” në Sektorin e Kontrollit të Zhvillimit dhe në Sektorin e Shërbimeve, si dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
5. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë aktin e emërimit nr.38, datë 29.04.2014, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist për Financën*”, si dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
6. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë aktin e emërimit nr. 40, datë 29.04.2014, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive*” dhe rikthimin në detyrë të nëpunëses civile \*\*\*\*\*.
7. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë aktin e emërimit nr.36, datë 21.03.2014, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Hartimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive*” dhe shpalljen si të lirë të këtij pozicioni pune.
8. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë, të revokojë aktin e emërimit nr.9, datë 04.06.2014, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Drejtoreshë Finance*” dhe aktin e emërimit nr.25, datë 13.03.2015, për nëpunësen civile \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjëse Sektorit*” në Sektorin e Financës dhe shpalljen si të lirë të këtij pozicioni pune.
9. Njësia përgjegjëse të shpallë pozicione të lira pune ato të sipërcituara dhe të vijojë me procedurat e konkurimit sipas përcaktimeve të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave.
10. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes*”

*dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (dosjen individuale).*

11. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural prej 30 ditësh të lënë për zbatimin e rekomandimeve në vendimin e mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Vendimin nr.89, datë 04.09.2015.

Me Urdhrin nr.145, datë 17.02.2016, të Komisionerit u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin, Këshilli i Qarkut Lezhë në datën 19.02.2016 dhe i kërkoi personit përgjegjës, nëpunësit \*\*\*\*\* , dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të verifikimit, rezultoi se : Njësia përgjegjëse për rekomandimet dhe detyrat e lëna në vendim ka kryer veprimet administrative si më poshtë duke nxjerrë aktet përkatëse.

Së pari: Në zbatim të rekomandimit të pikës 2 të vendimit të Komisionerit, rezulton si vijon:

Punonjësi \*\*\*\*\* është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “Specialist” me aktin administrativ nr.2, dt. 11.06.2014, sipas përcaktimeve në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka kërkuar revokimin e aktit administrativ nr. 94, datë 01.10.2014 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Drejtor i Burimeve Njerëzore” dhe revokimin e aktit administrativ nr. 26, datë 13.3.2015 Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë për emërimin e këtij punonjësi në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”. Shkaku për të cilin Komisioneri ka kërkuar revokimin e këtyre akteve është se ato kanë dalë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e për rrjedhojë bazuar në nenin 116 pika c dhe 117 pika 1 të ligjit nr.8485, dt.12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”(ligj i aplikueshëm në atë kohë, tashmë i shfuqizuar), këto akte janë absolutisht të pavlefshëm e duhet të revokohen. Nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë ka dalë Urdhri nr.86, dt.28.10.2015 “Për lirim nga detyra” të punonjësit \*\*\*\*\* . Si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me Vendimin nr.2, dt.29.02.2016 është miratuar struktura administrative e Këshillit të Qarkut Lezhë, e cila reduktohet në 10 pozicione të shërbimit civil.

Nga verifikimi i strukturës aktuale organizative të Këshillit të Qarkut Lezhë, miratuar me vendimin e mësipërm, punonjësi \*\*\*\*\* nuk është pjesë e strukturës, fakt i cili presupozon zbatimin e rekomandimit të mësipërm.

Së dyti: Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 3 të vendimit të Komisionerit, rezulton se njësia përgjegjëse ka vepruar si vijon:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit në pikën 3 të Vendimit nr. 89, datë 04.09.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Lezhë” ka kërkuar revokimin e aktit administrativ nr.17, datë 02.03.2015 të emërimit të punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve”, për arsye se ky akt ka dalë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Me hyrjen në fuqi të të ligjit 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Këshilli i Qarkut Lezhë, me anë të Vendimit nr.2, datë 29.02.2016 të titullarit të institucionit “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të këshillit të qarkut sipas sektorëve dhe specialiteteve” është miratuar struktura e Këshillit të Qarkut Lezhë për vitin 2016. Nga verifikimi i strukturës së mësipërme (organike dhe analitike) të Këshillit të Qarkut Lezhë pozicioni i punës “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve” nuk ekziton, por dhe punonjësi \*\*\*\*\* nuk figuron të jetë më punonjës i këtij institucioni, fakt i cili presupozon zbatimin e rekomandimit të mësipërm.

Së treti: Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 4 të vendimit të Komisionerit, nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë ka dalë Urdhri nr.83, dt.23.10.2015 “Për lirim nga detyra” të punonjësit \*\*\*\*\*.

Së katërti: Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 5 të vendimit të Komisionerit, rezultoi se njësia përgjegjëse ka kryer veprime si vijon:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit në pikën 5 të Vendimit nr. 89, datë 04.09.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Lezhë” ka kërkuar revokimin e aktit administrativ nr.38, datë 29.04.2014 të emërimit të punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist finance”, për arsye se ky akt ka dalë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Me hyrjen në fuqi të të ligjit 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Këshilli i Qarkut Lezhë, me anë të Vendimit nr.2, datë 29.02.2016 të titullarit të institucionit “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të këshillit të qarkut sipas sektorëve dhe specialiteteve” është miratuar struktura e Këshillit të Qarkut Lezhë për vitin 2016. Sipas strukturës së mësipërme pozicioni i punës “specialist finance” është shkurtuar dhe është emërtuar “specialist për shërbimet financiare dhe magazinat”, pozicion të cilin sipas kësaj strukture e mban nëpunësja civile \*\*\*\*\*.

Punonjësi \*\*\*\*\* nuk figuron të jetë më punonjës i këtij institucioni, fakt i cili presupozon zbatimin e rekomandimit të mësipërm.

Së pesti: Në zbatim të pikës 6 të vendimit të Komisionerit, nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë ka dalë Urdhri nr.84, dt.28.10.2015 “Për lirim nga detyra” të punonjësit \*\*\*\*\* dhe pas përfundimit të lejes së lindjes, punonjësja \*\*\*\*\* me Urdhrin nr. 35/1, datë 1.09.2016 është emëruar në detyrën “Specialiste”.

Së gjashti: Në zbatim të pikës 7 të vendimit të Komisionerit, nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë ka dalë Urdhri nr.75, dt.26.10.2015 “Për lirim nga detyra” të punonjësit \*\*\*\*\*.

Së shtati: Në zbatim të pikës 8 të vendimit të Komisionerit, rezultonse njësia përgjegjëse ka vepruar si vijon:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit në pikën 8 të Vendimit nr. 89, datë 04.09.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Lezhë” ka kërkuar revokimin e aktit administrativ nr.9, datë 04.06.2014 të emërimit të punonjëses \*\*\*\*\* në pozicionin “Drejtoresh Finance”, për arsye se ky akt ka dalë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Me hyrjen në fuqi të ligjit 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Këshilli i Qarkut Lezhë, me anë të Vendimit nr.2, datë 29.02.2016 të titullarit të institucionit “Për miratimin e strukturës së aparatit administrativ të këshillit të qarkut sipas sektorëve dhe specialiteteve” është miratuar struktura e Këshillit të Qarkut Lezhë për vitin 2016. Sipas strukturës së mësipërme pozicioni i punës “Drejtoresh finance” është shkurtuar. Gjithashtu, nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Lezhë ka dalë Urdhri nr.72, dt.23.10.2015 “Për lirim nga detyra” të punonjëses \*\*\*\*\*, për shkak të kërkesës së datës 25.09.2015 të kësaj punonjëse për dorëheqje nga detyra si “përgjegjëse finance”. Me urdhërin e mësipërm presupozohet i shfuqizuar edhe akti nr.25, datë 13.3.2015 i emërimit të punonjëses si “përgjegjëse finance”, edhe pse jo sipas rekomandimit të Komisionerit, por për shkak të dorëheqjes së punonjëses.

Së teti: Në lidhje me pikën 9 të vendimit të Komisionerit në të cilin është kërkuar shpallja e pozicioneve të lira dhe fillimi i procedurave të konkurimit për plotësimin e tyre, nga ana e Këshillit të Qarkut Lezhë nuk janë marrë masa për zbatimin e saj, për arsye se, institucioni është në proces ristrukturimi dhe pozicionet e mësipërme të mbetura vakant mund të suprimohen e për këtë arsye, nuk mund të shpallen si të lira.

Së nënti: Në lidhje me rekomandimin në pikën 10 të vendimit të Komisionerit, në të cilin kërkohet marrja e mendimit me shkrim të nëpunësve, nga ana e njësisë përgjegjëse të Këshillit të Qarkut Lezhë, rezulton se nuk është marrë mendimi me shkrim i nëpunësve. Por fakti që nëpunësit nuk e kanë kundërshtuar vendimin e komisionit të ristrukturimit, por e kanë pranuar sistemimin e tyre, do të thotë në fakt shprehje e mendimit “pro” dhe jo refuzim i vendimit. Momarrja e mendimit me shkrim të nëpunësve, nuk çënon apo e bën të pavlefshëm procedurën e transferimit të përhershëm e në këto kushte, pavarësisht mosmarrjes së aktit formal të mendimit me shkrim të nëpunësve, fakti që kja marrëdhënie pune vazhdon dhe nuk është refuzuar sipas përcaktimeve të pikës 21, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, konsiderohet e pranuar.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, u mbajt procesverbali i konstatimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 89, datë 04.09.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të

*inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Lezhë*”, është zbatuar, nga ana e subjektit, **Këshilli i Qarkut Lezhë**.

**Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin, Këshilli i Qarkut Lezhë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit nr. 89, datë 04.09.2015 *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Lezhë”*.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Këshilli i Qarkut Lezhë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**